

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR SHTETËSINË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Shtetësia shqiptare rregullohet nga nenet 19 e 92, shkronja “c”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të cilat përcaktojnë se fitimi i shtetësisë dhe lënia e saj parashikohen me ligj.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.8942, datë 19.9.2002, ka ratifikuar konventën evropiane “Për shtetësinë”.

Aktualisht, kuadri ligjor që rregullon fitimin dhe lënien e shtetësisë shqiptare përbëhet nga ligji nr.8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Që nga hyrja në fuqi e ligjit nr.8389, datë 5.8.1998, të ndryshuar, e deri më sot, veç ndryshimeve ligjore të lidhura me aktet normative të cituara më lart, të cilat diktojnë harmonizimin e tyre me kuadrin ligjor për shtetësinë, janë konstatuar dhe një sërë problematikash në zbatim. Në këtë kontekst, në Ministrinë e Brendshme u ngrit grupi ndërinstitucional i punës për hartimin e projektligjit “Për shtetësinë”, me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse.

Në kuadër të procesit të hartimit të këtij projektligji është analizuar kuadri ligjor ndërkombëtar i ratifikuar nga Republika e Shqipërisë dhe kuadri ligjor në fuqi, si dhe ai i miratuar që nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr.8389, datë 5.8.1998, të ndryshuar. Gjithashtu, u analizuan problematikat e ndeshura në praktikë gjatë zbatimit të këtij ligji dhe, pas vlerësimit të ndryshimeve që duhet të bëheshin në ligjin nr.8389, datë 5.8.1998, të ndryshuar, u arrit në konkluzionin që duhet të hartohet një projektligj i ri “Për shtetësinë”.

Ligji nr.8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, i ndryshuar, paraqitet shumë i hershëm dhe nuk u përgjigjet problematikave të konstatuara në praktikë, që kryesisht janë, si më poshtë vijon:

- Fitimi i shtetësisë në bazë të origjinës, sipas parashikimeve të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998, të ndryshuar, pothuajse barazohet në kriteret me fitimin e shtetësisë me natyralizim, ndërkohë që rregullim më i detajuar është bërë me akt nënligjor. Për këtë kategori shtetasish duhet të parashikohen kushte të

lehtësuara dhe më të favorshme, në krahasim me kategorinë e të huajve që fitojnë shtetësinë shqiptare me natyralizim.

- Zgjidhja e problematikave të mosregjistrimit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, të vitit 2010, të personave, të cilët kanë fituar shtetësinë shqiptare (me dekret të Presidentit). Mosparaqitja brenda një afati të caktuar për regjistrim pranë zyrave të gjendjes civile dhe pse nuk ka një afat ligjor të përcaktuar, ka sjellë si pasojë refuzimin nga ana e këtyre zyrave të regjistrimit të këtyre shtetasve. Si rrjedhojë, këta persona nuk mund të gëzojnë të drejtat që lidhen me të pasurit e shtetësisë shqiptare, siç janë: e drejta e votës, e punësimit në institucionet publike, pajisja me pasaportë apo letërnjoftim elektronik, duke mos bërë efektive shtetësinë shqiptare për këtë kategori.
- Lehtësimi i procedurave të fitimit të shtetësisë për personat, të cilët kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe kanë fituar një shtetësi të huaj, ndërkohë që në vijim kërkojnë të rimarrin shtetësinë shqiptare. Aktualisht, edhe për këtë kategori personash zbatohen kriteret e fitimit të shtetësisë me natyralizim, ndërkohë që duhet të përcaktohen dispozita më të favorshme ligjore, në veçanti, lidhur me kriterin e banimit apo të qëndrimit në mënyrë të vazhdueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pasi këta persona kanë pasur shtetësinë shqiptare.
- Regjistrimi në RKGJC 2010 i personave mbi 18 vjeç, të cilët kanë lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga prindër shqiptarë apo qoftë edhe njëri prind shqiptar, por që para kësaj moshe nuk janë regjistruar në zyrat e gjendjes civile në Shqipëri. Sipas parashikimit të nenit 19, të Kushtetutës, “Kushdo që lind duke pasur qoftë dhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare.”. Aktualisht, kjo kategori, që, për arsye objektive apo neglizhence nuk është regjistruar në RKGJC nuk ka mundur të regjistrohet dhe ka aplikuar për fitimin e shtetësisë nëpërmjet njohjes në bazë të origjinës, sipas rregullave të parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Me qëllim zbatimin e parimit kushtetues dhe njëkohësisht të detyrimit që ka Republika e Shqipërisë për të mbrojtur të drejtat kombëtare të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve të saj, në projektligj është parashikuar fitimi i shtetësisë në bazë të origjinës dhe është rregulluar e drejta e regjistrimit të personave që e kanë fituar shtetësinë me lindje.
- Zgjidhje e problematikës së krijuar në praktikë, për paraqitjen e kërkesës për heqje dorë nga shtetësia shqiptare në rast të prindërve të divorcuar. Aktualisht, legjislacioni kërkon që kërkesa duhet të paraqitet nga të dy prindërit, por ky parashikim ka krijuar probleme në rast të mosdakordësisë

dhe/ose mosgjetyes së njërit prind. Kështu që, në këto kushte, është parashikuar që, nëse prindërit janë të divorcuar, kërkesa për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare të bëhet nga prindi, të cilit i është lënë përgjegjësia prindërore me vendim gjykate të formës së prerë.

Projektligji i propozuar, krahas zgjidhjes së problematikave të sipërcituara synon trajtimin në mënyrë më të plotë të mënyrave të fitimit, rifitimit dhe heqjes dorë nga shtetësia shqiptare, rregullime, të cilat konsistojnë, si më poshtë vijon:

- Përcaktimi i parimeve, mbi bazën e të cilave bazohet kuadri ligjor që lidhet me shtetësinë shqiptare, i harmonizuar tërësisht me Konventën Evropiane, të ratifikuar;
- Projektligji parashikon si një nga mënyrat e fitimit të shtetësisë shqiptare fitimin e shtetësisë nëpërmjet origjinës, që është lidhja familjare, deri në tri shkallë, e kërkuarit me të paralindurit me shtetësi shqiptare.
- Janë rishikuar kriteret për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare, duke i qartësuar dhe specifikuar, aty ku është vlerësuar se ka pasur nevojë, siç është kriteri i qëndrimit, i lidhur me banimin në mënyrë të vazhdueshme, i disponimit të të ardhurave apo burimeve financiare të mjaftueshme për jetesën, përcaktimi i kriterit të zotërimit të gjuhës shqipe, si dhe i njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë.
- Janë parashikuar rastet e humbjes së shtetësisë shqiptare, ku është përcaktuar rasti i heqjes së shtetësisë shqiptare për shtetasit që e kanë fituar me natyralizim, nëse vërtetohet që shtetasi shqiptar që e ka të fituar shtetësinë shqiptare përkrah, kryen veprimtari apo është anëtar i organizatave, aktiviteti i të cilave synon cenimin e sigurisë kombëtare e të rendit kushtetues së Republikës së Shqipërisë.
- Gjithashtu, është rregulluar fitimi i shtetësisë shqiptare, në rastet të veçanta kur Republika e Shqipërisë ka një interes kombëtar apo interes në fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës, ekonomisë dhe sportit.
- Janë parashikuar dispozita që parashikojnë fitimin e shtetësisë nga refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese, duke përcaktuar si kusht qëndrimin në mënyrë të ligjshme dhe banimin në Republikën e Shqipërisë për një periudhë të vazhdueshme, prej jo më pak se 10 vjetësh nga dita e komunikimit të statusit. Në ndryshim nga periudha e qëndrimit për rastet e fitimit të shtetësisë me natyralizim, që propozohet të jetë 7 vjet, për refugjatët është vlerësuar që ky afat të jetë 10 vjet, për shkak të vërtetësisë së deklarimeve

apo dokumentacionit që paraqet kjo kategori. Përcaktimi i dokumentacionit të nevojshëm për fitimin e shtetësisë shqiptare për këtë kategori, përcaktohet me udhëzim të ministrit të Brendshëm.

- Janë përcaktuar në mënyrë kronologjike dispozitat lidhur me paraqitjen e shqyrtimin e kërkesës, duke përcaktuar edhe institucionet përgjegjëse për trajtimin e saj.
- Është përcaktuar qartësisht kompetenca në lidhje me të drejtën për t'i propozuar institucionit përgjegjës kushtetues, Presidentit të Republikës, nxjerrjen e dekretit, moment i lidhur ngushtësisht me garancinë ligjore të ankimit, që duhet të gëzojë një person që është subjekt i këtij projektligji. Ky parashikim është bërë në përputhje të plotë me shkronjën “c”, të nenit 92, të Kushtetutës, ku parashikohet se:

“Presidenti ushtron dhe këto kompetenca:

... c) jep shtetësinë shqiptare dhe lejon lënien e saj sipas ligjit.”.

Gjithashtu, në këtë kontekst është vlerësuar e nevojshme që të parashikohet se, në rast se pas verifikimeve të kryera nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në projektligj për fitimin, rifitimin ose heqjen dorë nga shtetësia shqiptare, Ministria e Brendshme të njoftojë personin e interesuar për refuzimin e kërkesës së paraqitur. Kundër aktit administrativ për refuzimin e kërkesës, personi mund të bëjë ankim në gjykatën kompetente administrative. Në ligjin nr.8389/1998, të ndryshuar, ky moment nuk ishte shprehur qartë dhe krijonte konfuzion.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve të Ministrisë së Brendshme, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji “Për shtetësinë” përcakton parimet dhe rregullat për fitimin, rifitimin dhe humbjen e shtetësisë shqiptare, si dhe është harmonizuar me legjislacionin ndërkombëtar të ratifikuar e me kuadrin ligjor kombëtar në fuqi.

Për hartimin e këtij projektligji, grupi ndërinstitucional i punës ka studiuar legjislacionin ndërkombëtar, legjislacionin e disa shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe legjislacionin kombëtar të miratuar, që nga hyrja në fuqi e ligjit nr.8389, datë 5.8.1998, të ndryshuar, objekt shfuqizimi.

Projektligji i propozuar ka zgjeruar mënyrat e fitimit të shtetësisë, duke parashikuar edhe fitimin e shtetësisë me origjinë, duke i dhënë mundësinë dhe asaj pjese të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, si pjesës që ka emigruar në mënyrë të hershme, por dhe të pjesës që ka emigruar pas ndryshimeve që ndodhën në vendin tonë, pas viteve '90, e që dëshirojnë të kenë një lidhje të qëndrueshme juridike me shtetin shqiptar, por që njëkohësisht kanë mbajtur e ruajtur lidhje gjuhësore, kulturore e të traditës me Shqipërinë.

Projektligji ka përcaktuar kritere më të qarta, për fitimin e shtetësisë shqiptare, të cilat ndryshojnë në varësi të mënyrës së fitimit e të kategorisë së të huajve, duke përcaktuar kritere të ndryshme, p.sh. për refugjatët apo personat në mbrojtje plotësuese.

Në rastin e rifitimit të shtetësisë shqiptare janë përcaktuar kritere më të lehtësuara, duke qenë se personi ka qenë shtetas shqiptar dhe ndaj tij nuk mund të aplikohen kritere të njëjta me shtetasit e huaj, por, gjithsesi, duke respektuar parimin e mosdiskriminimit.

Projektligji parashikon dhe rregullon rastet e veçanta të fitimit të shtetësisë në rastet kur Republika e Shqipërisë ka një interes kombëtar apo interes në fushën e arsimit, shkencës, artit, kulturës, ekonomisë dhe sportit, duke autorizuar rregullimin me akt nënligjor, pasi një gjë e tillë ka munguar, duke bërë që të mos ndiqet një procedurë e përcaktuar dhe e unifikuar për të gjitha rastet, në institucionet përgjegjëse.

Janë parashikuar kushtet për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare dhe, në veçanti, për fëmijën, siç është rregullimi i rastit të heqjes dorë për fëmijën me prindër të divorcuar. Në këtë rast, kërkesa për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare bëhet nga prindi, të cilit i është lënë përgjegjësia prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, duke zgjidhur problematikën e lidhur më pëlqimin e prindit tjetër, kur ai nuk gjendet apo “refuzon” dhënien e pëlqimit.

Projektligji parashikon procedurat për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare, duke përcaktuar qartë institucionet përgjegjëse, ku paraqitet dhe shqyrtohet kërkesa. Janë rishikuar e ndryshuar afatet procedurale për shqyrtimin e kërkesës dhe të dokumentacionit shoqërues, pas analizës së bërë për shmangien e problematikave të shkaktuara në drejtim të vonesave apo

kapërcimit të afateve për shkaqe objektive, të lidhura në veçanti me verifikimet që bëhen për përmbushjen e kushteve ligjore pranë institucioneve përkatëse.

Është parashikuar heqja e shtetësisë shqiptare në rastet kur shtetasi shqiptar që e ka fituar shtetësinë me natyralizim përkrah, kryen veprimtari apo është anëtar i organizatave, aktiviteti i të cilave synon cenimin e sigurisë kombëtare e të rendit kushtetues të Republikës së Shqipërisë. Kjo dispozitë është një rast përjashtimor i heqjes së shtetësisë pa kërkesë, por është në përputhje me parashikimet e parimet kushtetuese, për sa kohë synon të mbrojë sigurinë kombëtare dhe rendin kushtetues të Republikës së Shqipërisë. Humbja e shtetësisë shqiptare në këtë rast zbatohet vetëm për shtetasit që e kanë fituar shtetësinë shqiptare me natyralizim dhe nëse personi nuk rrezikon të mbetet pa shtetësi, duke respektuar njëkohësisht detyrimet që ka vendi ynë në kuadër të aderimit në konventat e shtetësisë e të reduktimit të pashtetësisë. Shtetësia shqiptare hiqet me dekret të Presidentit të Republikës, vetëm pas kryerjes së procedurave të verifikimit nga institucionet përgjegjëse ligjzbatuese apo kur shtetasi është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Vetë shtetësia është marrëdhënie të drejtash dhe detyrimesh. Pra, nëse një person që ka fituar shtetësinë *in fide* nuk përmbush detyrimet, mund të humbasë shtetësinë, por gjithmonë duke respektuar parimet kushtetuese dhe detyrimet ndërkombëtare.

Gjithashtu, nisur nga fakti që, në shumë raste, shtetas, të cilët kanë fituar shtetësinë shqiptare me dekret të Presidentit, por që nuk janë regjistruar në RKGJC të vitit 2010, gjë që ka sjellë si pasojë refuzimin për regjistrimin e këtyre shtetasve, në projektligj është parashikuar bërja e betimit brenda 6 muajve nga njoftimi i dekretit për fitimin e shtetësisë shqiptare; në të kundërt, dekreti nuk do të ketë efekt, e lidhur kjo jo me vlefshmërinë e aktit, por të rëndësisë së betimit për efekt të regjistrimit e të përfitimit të të drejtave që burojnë nga të qenit shtetas i një shteti.

Për të zgjidhur çështjen e pashtetësisë në projektligj, por dhe për të lehtësuar kriteret për rifitimin e saj, është vlerësuar i nevojshëm përcaktimi i një afati për shtetasit shqiptarë që kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare për shkak të premtimit për fitimin e një shtetësie tjetër. Nëse ata nuk e fitojnë shtetësinë e premtuar, duhet të paraqesin kërkesë për rifitimin e shtetësisë shqiptare brenda një afati të arsyeshëm, por jo më shumë se dy vjet nga heqja dorë, me përjashtim të rasteve kur shtetasi nuk ka mundur të respektojë këtë afat, për shkaqe objektive. Në këtë rast, kushtet që duhet të plotësojë personi janë më të favorshme, krahasuar me shtetasit e huaj.

Gjithashtu, për të zgjidhur çështjen e pashtetësisë, është parashikuar si dispozitë kalimtare dhe e drejta për të rifituar shtetësinë shqiptare mbi bazën e kërkesës së personave që kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare para hyrjes në fuqi të këtij

projektligji dhe nuk kanë fituar shtetësinë e premtuar. Me qëllim që për këtë kategori të mos zbatohet afati dyvjeçar i përcaktuar në projektligj, është vlerësuar që ky rregullim të bëhet në dispozitat kalimtare.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Baza ligjore e projektligjit janë nenet 81, pika 2, shkronja “b”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Projektligji “Për shtetësinë” është hartuar në përputhje edhe me dispozitat e Kushtetutës:

- Me nenin 19, ku përcaktohet se:

“1. Kushdo që lind duke pasur qoftë edhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare. Shtetësia shqiptare fitohet edhe për shkaqe të tjera të parashikuara me ligj.

2. Shtetasi shqiptar nuk mund ta humbasë shtetësinë, përveçse kur ai heq dorë prej saj.”.

- Me nenin 92, shkronja “c”, ku përcaktohet se:

“Presidenti ushtron edhe këto kompetenca:

c) jep shtetësinë shqiptare dhe lejon lënien e saj sipas ligjit;”.

Projektligji i propozuar është në harmoni me Konventën Evropiane “Për shtetësinë”, të ratifikuar me ligjin nr.8492, datë 19.9.2002 dhe me konventën “Për reduktimin e pashtetësisë”, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.9059, datë 8.5.2003, si dhe me legjislacionin kombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE TË BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji “Për shtetësinë” nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian, por është në harmoni me Konventën Evropiane “Për shtetësinë”, të ratifikuar me ligjin nr.8942, datë 19.9.2002, “Për ratifikimin e konventës evropiane “Për shtetësinë”, si dhe me konventën “Për reduktimin e pashtetësisë”, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.9059, datë 8.5.2003.

Gjithashtu, në hartimin e këtij projektligji grupi ndërinstitucional i punës ka kryer hulumtime të sistemeve të disa shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, si: Italia, Kroacia, Sllovenia etj. dhe është marrë në konsideratë legjislacioni i atyre vendeve, të cilat kanë sistem të përafërt me atë të vendit tonë, duke mos synuar përafrimin e modelit, por arritjen e standardeve.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 4 krerë dhe 26 nene.

Në kreun e parë është përcaktuar objekti, përkufizimet dhe parimet, këto të fundit në harmoni të plotë me konventën evropiane “Për shtetësinë”.

Në kreun e dytë përcaktohen mënyrat e fitimit të shtetësisë, rifitimi dhe rastet e humbjes së shtetësisë shqiptare.

Kështu, në nenin 4, të projektligjit, është parashikuar që shtetësia shqiptare fitohet me lindje, origjinë, lindje në territorin e Republikës së Shqipërisë, me natyralizim dhe birësim.

Në nenin 5, të projektligjit, janë parashikuar rastet e fitimit të shtetësisë me lindje (*jus sanguinis*), ku është parashikuar që kushdo që lind, duke pasur qoftë dhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare, e fiton vetiu shtetësinë shqiptare me lindje dhe regjistrohet si shtetas shqiptar në RKGJC-në e vitit 2010. Nisur nga problematikat e hasura në praktikë për këtë parashikim ligjor, sipas të cilit shtetasit që kanë lindur nga të paktën një prind shqiptar dhe kanë qenë mbi 18 vjeç, nuk kanë mundur të regjistrohen si shtetas shqiptarë, në projektligj është garantuar regjistrimi i tyre edhe pasi mbushin 18 vjeç, duke parashikuar që kjo e drejtë nuk parashkruhet.

Në nenin 6, të projektligjit, është parashikuar fitimi i shtetësisë nga persona me origjinë shqiptare, e cila fitohet nga i huaji, të paralindurit e të cilit kanë apo kanë pasur shtetësinë shqiptare në momentin e paraqitjes së kërkesës, me kusht që të provohet lidhja familjare në vijë të drejtë, deri në tri shkallë, e kërkuesit me të paralindurin. Në këtë rast shtetasi paraqet kërkesë për fitimin e shtetësisë shqiptare në bazë të origjinës dhe plotëson vetëm kushtet ligjore të lidhura me të qenit i padënuar, sipas specifikimeve të bëra në projektligj dhe të mos përbëjë kërcënim për rendin publik e sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë.

Në nenin 7 është parashikuar fitimi i shtetësisë shqiptare me lindje në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe zbatohet vetëm për fëmijët e lindur ose të gjetur

brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllimin e vetëm për të shmangur pashtetësinë (zbatimi pjesërisht i *jus soli*-it).

Në nenin 8, të projektligjit, janë parashikuar kushtet që duhet të plotësohen nga shtetasi i huaj për fitimin e shtetësisë shqiptare me natyralizim. Janë rishikuar kushtet ekzistuese për fitimin e shtetësisë shqiptare, duke specifikuar aty ku është vlerësuar e nevojshme. Është rishikuar kriteri i qëndrimit që lidhet me banimin në mënyrë të vazhdueshme, përcaktimi i kriterit të zotërimit të gjuhës shqipe, si dhe i njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë, kriteri i të ardhurave apo i burimeve financiare të mjaftueshme për jetesën.

Në këtë nen është rregulluar edhe fitimi i shtetësisë së personit pa shtetësi, nëse ai plotëson kushtet e përcaktuara për këtë kategori, që janë më të lehtësuara në krahasim me fitimin e shtetësisë me natyralizim nga personat e huaj që kanë një shtetësi.

Janë parashikuar kushtet e fitimit të shtetësisë nga i huaji, që është martuar me një shtetas shqiptar, dhe pasojat e fitimit të shtetësisë shqiptare me natyralizim për fëmijën.

Në nenin 9 janë parashikuar rastet e veçanta të fitimit të shtetësisë shqiptare, në rastet kur Republika e Shqipërisë ka një interes kombëtar apo interes në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, artit, ekonomisë dhe sportit, duke autorizuar me akt nënligjor kriteret, procedurat e kryerjes së verifikimeve dhe të kontrolleve të nevojshme nga institucionet përgjegjëse, rregullat dhe/ose programet e veçanta që mund të zbatohen për rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni. Aktet nënligjore do të propozohen nga ministrat përgjegjës, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

Në nenin 10, të projektligjit, është parashikuar fitimi i shtetësisë shqiptare me birësim, në bazë të të cilit fëmija që birësohet fiton shtetësinë shqiptare, si në rastin kur të dy prindërit janë me shtetësi shqiptare, ashtu edhe në rastin kur vetëm njëri prej tyre është me shtetësi shqiptare, si dhe në çdo rast tjetër kur fëmija rrezikon të mbetet pa shtetësi, si rezultat i birësimit.

Në nenin 11, të projektligjit, është parashikuar fitimi i shtetësisë shqiptare nga refugjatët apo personat në mbrojtje plotësuese, duke vendosur kusht qëndrimin në mënyrë të ligjshme dhe banimin në mënyrë të vazhdueshme në Republikën e Shqipërisë, për një periudhë prej jo më pak se 10 vjetësh nga dita e komunikimit të statusit. Dokumentacioni që kërkohet për këtë kategori, me qëllim fitimin e shtetësisë shqiptare, është i ndryshëm nga kategoria e të huajve të tjerë për shkak të arsyeve e të rrethanave se pse ata kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në

Republikën e Shqipërisë (neni 1/A, i konventës së Gjenevës “Për statusin e refugjatit”) dhe përcaktohet me udhëzim të ministrit.

Në nenin 12 janë parashikuar rastet e humbjes së shtetësisë. Kështu, shtetësia shqiptare hiqet me kërkesë të shtetasit dhe kur plotëson kushtet e përcaktuara në projektligj (neni 13) dhe rastet kur heqja e shtetësisë bëhet pa kërkesë të shtetasit, në rastet e përcaktuara në këtë projektligj (neni 15).

Në nenin 13, të projektligjit, janë parashikuar kushtet që duhet të plotësojë një person që të mund të heqë dorë nga shtetësia shqiptare, me kërkesë.

Në nenin 14, të projektligjit, janë rregulluar rastet për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare për fëmijën, të lidhura ngushtësisht me dhënien e pëlqimit nga të dy prindërit. Gjithashtu, në këtë nen është përcaktuar heqja dorë nga shtetësia për fëmijën kur prindërit janë të divorcuar. Në këtë rast është parashikuar që kërkesa të bëhet nga prindi, të cilit i është lënë përgjegjësia prindërore, me vendim gjykate të formës së prerë, duke marrë pëlqimin e prindit tjetër. Pëlqimi i prindit tjetër nuk është i nevojshëm nëse ai nuk ka një vendbanim të regjistruar brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, apo jashtë saj, apo i është hequr përgjegjësia prindërore me vendim të gjykatës.

Në nenin 15, të projektligjit, janë parashikuar rastet e heqjes së shtetësisë shqiptare pa kërkesë dhe, konkretisht, shtetësia hiqet:

- a) kur vërtetohet se shtetasi ka paraqitur dokumente të falsifikuara për fitimin e shtetësisë. Në këtë rast shtetësia hiqet në bazë të informacioneve të verifikuara nga institucionet përgjegjëse ligjzbatuese dhe brenda një afati 10-vjeçar nga bërja e betimit.
- b) kur shtetasi përkrah, kryen veprimtari apo është anëtar i organizatave, aktiviteti i të cilave synon cenimin e sigurisë kombëtare dhe të rendit kushtetues së Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast shtetësia shqiptare hiqet në bazë të informacioneve të verifikuara nga institucionet përgjegjëse ligjzbatuese apo kur shtetasi është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, vetëm për shtetasit që e kanë fituar shtetësinë shqiptare me natyralizim dhe nëse personi nuk rrezikon të mbetet pa shtetësi.

Heqja e shtetësisë shqiptare bëhet me dekret të Presidentit dhe është parashikuar e drejta e ankimit të shtetasit kundër këtij akti administrativ. Heqja e shtetësisë, sipas parashikimeve të këtij neni, nuk ka efekt për fëmijët (ku, sipas përkufizimit të bërë në ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, përfshihen personat nën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç) e shtetasit që u hiqet shtetësia.

Në nenin 16, të projektligjit, është parashikuar rifitimi i shtetësisë shqiptare, ku janë lehtësuar kushtet që duhet të plotësojë personi, i cili paraqet kërkesë për rifitimin e shtetësisë shqiptare. Në këtë rast personi paraqet kërkesë për rifitimin e shtetësisë shqiptare sipas procedurës së përcaktuar për fitimin e saj.

Në kreun III janë përcaktuar procedurat që ndiqen nga institucionet përgjegjëse për fitimin, rifitimin dhe humbjen e shtetësisë shqiptare.

Në nenin 17, të projektligjit, është rregulluar paraqitja e kërkesës nga personat që jetojnë brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ku është parashikuar se dokumentacioni i nevojshëm përcaktohet me udhëzim të ministrit. Kështu, në rastet e aplikimit për shtetësinë shqiptare, kërkesa paraqitet pranë strukturave vendore përgjegjëse të Policisë së Shtetit, ndërsa, në rastet e aplikimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kërkesa paraqitet pranë misionit diplomatik apo postit konsullor të Republikës së Shqipërisë, akredituar në shtetin ku ka vendbanimin personi. Tarifa që aplikohet për fitimin, rifitimin apo heqjen dorë nga shtetësia shqiptare është vlerësuar që ka nevojë të ndryshojë, duke e rritur, në mënyrë që t'i përgjigjet shërbimit që kryhet. Përcaktimi i vlerës do të bëhet me udhëzim të përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe ministrit përgjegjës për financat.

Në nenin 18 është parashikuar procedura nga paraqitja e kërkesës deri në dërgimin e saj dhe të dokumentacionit shoqërues në Institucionin e Presidentit të Republikës për nxjerrjen e dekretit. Është qartësuar kompetenca në lidhje me të drejtën e propozimit kundrejt institucionit përgjegjës në përputhje me Kushtetutën për nxjerrjen e dekretit. Gjithashtu, janë përcaktuar afatet për shqyrtimin e verifikimin e kërkesës dhe të dokumentacionit shoqërues. Kështu, Ministria e Brendshme duhet të shqyrtojë e të verifikojë dokumentacionin brenda 6 (gjashtë) muajve. Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, Ministria e Brendshme, brenda 45 ditëve, ua kthen strukturave dhe institucioneve të përcaktuara në pikat 1 e 2, të këtij neni, të cilat njoftojnë personin e interesuar brenda një afati 15-ditor. Pas plotësimit të dokumentacionit, Ministria e Brendshme vijon me procedurat e verifikimit, me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore dhe, në përfundim, i propozon Presidentit të Republikës nxjerrjen e dekretit.

Në rast se pas verifikimeve të kryera nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë projektligj, Ministria e Brendshme njofton personin e interesuar për refuzimin e kërkesës së paraqitur me akt administrativ. Kundër këtij akti administrativ, personi që ka paraqitur kërkesën mund të bëjë ankim në gjykatën kompetente administrative.

Në nenin 19, të projektligjit, është parashikuar procedura e heqjes së shtetësisë, duke përcaktuar ministrinë si autoritet përgjegjës për bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse për verifikimin e informacionit, sipas procedurës së përcaktuar me udhëzim të ministrit.

Në nenin 20, të projektligjit, është parashikuar nxjerrja e dekretit për fitimin, rifitimin dhe lënien e shtetësisë. Afati i përcaktuar për nxjerrjen e dekretit është vendosur 60 ditë nga paraqitja e propozimit nga Ministria e Brendshme, si dhe mënyra e komunikimit të dekretit nga Institucioni i Presidentit, personit të interesuar. Dekreti botohet në “Fletoren zyrtare” dhe regjistrohet në një regjistër të veçantë për qëllime statistikore.

Në nenin 21, të projektligjit, është parashikuar kryerja e betimit të personit që ka fituar shtetësinë shqiptare, me natyralizim apo origjinë, para kryetarit të bashkisë apo personit të autorizuar prej tij, në territorin ku personi ka vendbanimin, për besnikëri ndaj shtetit shqiptar dhe për respektimin e Kushtetutës e të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Në nenin 22, të projektligjit, është parashikuar afati për bërjen e betimit, i cili është 6 muaj nga data e njoftimit të dekretit, si dhe është rregulluar shtyrja e afatit për shkaqe objektive e të arsyeshme. Dekreti nuk ka efekt pa kryerjen e betimit. Kryerja e betimit bëhet sipas procedurës së parashikuar në legjislacionin e gjendjes civile.

Në kreun IV janë parashikuar dispozitat kalimtare dhe të fundit.

Në nenin 23, të projektligjit, është parashikuar shfuqizimi i ligjit nr.8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare” dhe i vendimit nr.554, datë 3.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave për njohjen ose fitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare, me përjashtim të shtetasve të Republikës së Kosovës”.

Në nenin 24, të projektligjit, është parashikuar dispozita kalimtare, e lidhur me personat që kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare para hyrjes në fuqi të këtij projektligji, ku përcaktohet se kjo kategori do të vazhdojë të trajtohet sipas ligjit aktual të shtetësisë dhe se personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare para hyrjes në fuqi të këtij projektligji dhe nuk ka apo ka fituar shtetësi tjetër, do ta rifitojë shtetësinë shqiptare mbi bazën e kërkesës e të dokumentacionit shoqërues, nëse nuk përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë kombëtare. Edhe në këtë rast do të zbatohet ligji nr.8389, datë 5.8.1998, i ndryshuar.

Në nenin 25, të projektligjit, është parashikuar nxjerrja e akteve nënligjore nga organet kompetente, çështjet që duhen rregulluar, sipas dispozitave përkatëse

deleguese dhe afatet brenda të cilave duhet të nxirren aktet nënligjore, në zbatim të këtij projektligji.

Në nenin 26, të projektligjit, është parashikuar që ky projektligj të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës dhe kryetarët e bashkive.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga grupi ndërinstitutional i punës, i ngritur me urdhër të ministrit të Brendshëm, në të cilin ka pasur përfaqësues të strukturave përgjegjëse të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Kulturës.

Gjithashtu, në mbledhjet e grupit ndërinstitutional të punës ka marrë pjesë si i ftuar, me qëllim diskutimin e problematikave të ndeshura në zbatim të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998, përfaqësues nga Institucioni i Presidentit të Republikës.

Ky projektligj është publikuar në regjistrin elektronik të njoftimeve dhe të konsultimeve publike nga data 14.1.2019 deri më 8.2.2019.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji nuk shoqërohet me efekte financiare shitesë për buxhetin e shtetit, përkundrazi, do të ketë efekte financiare pozitive nga të ardhurat që do të mblidhen nga tarifa që do të aplikohet për shtetësinë, përcaktimi i së cilës do të bëhet me akt nënligjor, në zbatim të këtij projektligji.

KËSHILLI I MINISTRAVE